



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT  
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – URED PREDSEDNIKA

## **KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN**

Shtojca 1

### **Rekomandimet e takimit të gjashtë** **17 dhjetor 2013, Prishtinë**

1. Të hartohet një rishikim gjithëpërfshirës për reformën në sistemin e drejtësisë, që do të orientonte angazhimin e institucioneve të ndryshme, do të bënte më të matshëm vlerësimin e arritjeve dhe do të ndihmonte në bashkërendimin e aktiviteteve në mes të aktorëve të ndryshëm.
2. Të ketë fokusim të shtuar në forcim të llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, që nënkupton një model më të avancuar dhe më efikas të llogaridhënies së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial.
3. Të ndërmerren studime të cilat duhet të rezultojnë me rekomandime konkrete se si të vazhdohet me reformën e Drejtësisë Penale, Civile dhe Administrative.
4. Të ketë fokusim të shtuar në reformën e administratës, stafit mbështetës në administratën gjyqësore, dhe të krijohet një mekanizëm më efikas për kontrollin e performancës.
5. Të sigurohet ndarja e resurseve adekuate për të mundësuar zbatimin e plotë të ligjeve, sidomos atyre bazike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial.